



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 198/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Nenad Lazić dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjore Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Lipjan, paraqitur kundër Metush Sinanit Menaxher i shkollës “Idriz Ajeti” në fshatin Rusinocv të Komunës së Lipjanit, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa Anr 198/2017 e datës 11.06.2017 parashtruar nga Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Lipjan

## A r s y e t i m

Me datën 11.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Lipjan në të cilën pretendohet se në fshatin Rusinocv të Komunës së Lipjanit në shkollën fillore “Idriz Ajeti” vendvotimi 1324/E nuk janë lejuar vëzhguesit e akredituar të AKR-së që të hynë brenda në këtë vendvotim me arsyetim se nuk ka hapësirë të mjaftueshme për të asistuar gjatë procesit të votimit, e ku ky mos lejim sipas parashtruesit të ankesës është bërë nga Metush Sinani menaxher i shkollës “Idriz Ajeti”. Parashtruesi i ankesës kërkon që në përputhje me dispozitat ligjore të ndërmerren masa ndaj personave përgjegjës.

Paneli, pasi që shqyrtoj shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar:**

Parashtruesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se në fshatin Rusinocv të Komunës së Lipjanit në shkollën fillore “Idriz Ajeti” në vendvotimin 1324/E vëzhguesit e AKR-së nuk janë lejuar që të hynë brenda në këtë vendvotim me arsyetim se nuk ka hapësirë të mjaftueshme.

Paneli, vlerëson se ankesa e parashtruar është e pa bazuar në mungesë të legjitimitetit aktiv, sepse subjekti politik AKR është i certifikuar si koalicion me LDK-AKR e jo si subjekt politik i vetëm, andaj parashtruesit të ankesës i mungon legjitimiteti aktiv për parashtrim të ankesës.

Prandaj, PZAP-i në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 198/2017 më datën 12.06.2017

**Kryesuesi i Panelit**

**Faton Ademi**



***Këshillë Juridike:***

*Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*